

31973L0240

Direktiva e Këshillit 73/240/KEE, datë 24 korrik 1973, që heq kufizimet mbi lirinë e vendosjes në veprimtarinë tregtare të sigurimit të drejtpërdrejtë me përjashtim të sigurimit të jetës

Gazeta Zyrtare L 228 , 16/08/1973 fq. 0020 - 0022
Botimi i posaçëm në gjuhën finlandeze: Kapitulli 6 Vëllimi 1 fq. 0160
Botimi i posaçëm në gjuhën greke Kapitulli 6 Vëllimi 1 fq. 0174
Botimi i posaçëm në gjuhën suedeze Kapitulli 6 Vëllimi 1 fq. 0160
Botimi i posaçëm në gjuhën spanjolle Kapitulli 6 Vëllimi 1 fq. 0158
Botimi i posaçëm në gjuhën portugeze Kapitulli 6 Vëllimi 1 fq. 0158
Botimi i posaçëm në gjuhën çeke Kapitulli 6 Vëllimi 1 fq. 31 - 33
Botimi i posaçëm në gjuhën estoneze Kapitulli 6 Vëllimi 1 fq. 31 - 33
Botimi i posaçëm në gjuhën hungareze Kapitulli 6 Vëllimi 1 fq. 31 - 33
Botimi i posaçëm në gjuhën lituaneze Kapitulli 6 Vëllimi 1 fq. 31 - 33
Botimi i posaçëm në gjuhën letoneze Kapitulli 6 Vëllimi 1 fq. 31 - 33
Botimi i posaçëm në gjuhën malteze Kapitulli 6 Vëllimi 1 fq. 31 - 33
Botimi i posaçëm në gjuhën polake Kapitulli 6 Vëllimi 1 fq. 31 - 33
Botimi i posaçëm në gjuhën sllovaqe Kapitulli 6 Vëllimi 1 fq. 31 - 33
Botimi i posaçëm në gjuhën sllovene Kapitulli 6 Vëllimi 1 fq. 31 - 33

Direktivë e Këshillit datë 24 korrik 1973 që heq kufizimet mbi lirinë e vendosjes në veprimtarinë tregtare të sigurimit të drejtpërdrejtë me përjashtim të sigurimit të jetës

(73/240/KEE)

KËSHILLI I KOMUNITETEVE EUROPIANE,

Duke pasur parasysh Traktatin Themelues të Komunitetit Europian dhe në veçanti nenin 54 paragrafi 2 dhe nenin 3 të tij,

Duke pasur parasysh Programin e Përgjithshëm [1] për ndalimin e kufizimeve mbi lirinë e vendosjes dhe në veçanti Titullin IV C të tij;

Duke pasur parasysh propozimin e Komisionit,

Duke pasur parasysh opinionin e Parlamentit Europian [2],

Duke pasur parasysh opinionin e Komitetit Ekonomik dhe Social (3)

Meqë Programi i Përgjithshëm i lartpërmendur parashikon ndalimin e çdo trajtimi diskriminues të shtetasve të Shteteve të tjera Anëtare sa i takon vendosjes në veprimtarinë tregtare të sigurimit të drejtpërdrejtë pa përfshirë sigurimin e jetës;

Meqë, sipas këtij Programi të Përgjithshëm, heqja e kufizimeve mbi krijimin e agjencive dhe degëve në lidhje me ndërmarrjet e sigurimit të drejtpërdrejtë varet nga bashkërendimi i kushteve të fillimit dhe ndjekjes së veprimtarisë tregtare; meqë ky bashkërendim për sigurimin e drejtpërdrejtë me përjashtim të sigurimit të jetës është arritur me Direktivën e Këshillit të datës 24 korrik 1973;

Meqë fusha e veprimit të kësaj direktive është në çdo aspekt e njëjtë me objektin e përkufizuar në pikën A të shtojcës të Direktivës së parë për bashkërendimin; meqë në ato kushte, për qëllimet e bashkërendimit, dukej e arsyeshme të përjashtohet sigurimi i kredisë për eksportet;

Meqë, në përputhje me Programin e Përgjithshëm të përmendur më lart, duhen hequr kufizimet mbi të drejtën për t'u anëtarësuar në organizata profesionale kur ushtrimin e kësaj të drejte e kërkojnë veprimtaritë profesionale të personave të interesuar;

KA MIRATUAR KËTË DIREKTIVË

Neni 1

Shtetet Anëtare heqin në lidhje me personat fizikë dhe ndërmarrjet që mbulon Titulli I i Programit të Përgjithshëm për heqjen e kufizimeve mbi lirinë e vendosjes, më tej të quajtur "përfituesit", kufizimet e përmendura në Titullin III të këtij programi të cilat prekin të drejtën e fillimit dhe ndjekjes të veprimtarive me vetëpunësim në klasat e sigurimit të parashikuara në nenin 1 të Direktivës së parë për Bashkërendimin.

"Direktiva e Parë për Bashkërendimin" është Direktiva e parë e Këshillit, datë 24 korrik 1973, për bashkërendimin e akteve ligjore, nënligjore dhe administrative që kanë të bëjnë me fillimin dhe ndjekjen e veprimtarisë së sigurimit të drejtpërdrejtë me përjashtim të sigurimit të jetës.

Sidoqoftë do të ruhen këto kufizime në rastin e sigurimit të kredisë për eksportet, gjersa të jetë realizuar programi i bashkërendimit i parashikuar në nenin 2 pika 2 shkronja "d" të Direktivës së parë për bashkërendimin.

Neni 2

1. Shtetet Anëtare heqin, në veçanti, kufizimet:

(a) që i pengojnë përfituesit të vendosen në vendin pritës me të njëjtat kushte dhe të drejta me ato që zbatohen për shtetasit e vendit pritës;

(b) që ekzistojnë për shkak të praktikave administrative sipas të cilave trajtimi që u bëhet përfituesve është diskriminues në krahasim me trajtimin që u bëhet shtetasve.

2. Kufizimet që duhen hequr përfshijnë në veçanti ato që rrjedhin nga masat që e pengojnë ose e kufizojnë vendosjen e përfituesve si më poshtë:

(a) në Gjermani:

dispozitat që i japin Ministrisë Federale të Punëve Ekonomike të drejtën diskreciale për të vendosur kushtet e veta për fillimin e kësaj veprimtarie tregtare nga shtetasit e huaj dhe për të mos i lejuar këta ta ndjekin këtë veprimtari tregtare në Republikën Federale (Ligji i datës 6 qershor 1931 (VAG), neni 106 pika 2 nën-pika 1 në bashkëpunim me nenin 8 pika 1 nën-pika 3, nenin 106 pika 2 fjalë e fundit dhe nenin 111 pika 2);

(b) në Belgjikë:

detyrimi për të pasur "carte professionnelle" (neni 1 i Ligjit të datës 19 shkurt 1965);

(c) në Francë:

- nevoja për të marrë pëlqimin e posaçëm (Ligji i datës 15 shkurt 1917, i ndryshuar dhe i plotësuar me "décret-loi" të datës 30 tetor 1935, neni 2 pika 2 -- "décret" i datës 19 shkurt 1941, i ndryshuar, neni 1 dhe 2 -- "décret" i datës 13 gusht 1947, i ndryshuar, neni 2 dhe 10);

- detyrimi për të paraqitur obligacione me garanci ose garanci të posaçme si kërkesë reciproke (Ligji i datës 15 shkurt 1917, i ndryshuar dhe i plotësuar me "décret-loi" të datës 30 tetor 1935, neni 2 pika 2 - "décret-loi" i datës 14 qershor 1938, neni 42 -- "décret" i datës 30 dhjetor 1938, i ndryshuar, neni 143 -- "décret" i datës 14 dhjetor 1966, neni 9, 10 dhe 11);

- detyrimi për të depozituar rezerva teknike ("décret" i datës 30 dhjetor 1938, i ndryshuar, neni 179 — "décret" i datës 13 gusht 1947, i ndryshuar, neni 8 dhe 13 — "décret" i datës 14 dhjetor 1966, Titulli I).

(d) në Irlandë:

dispozita sipas së cilës, për të pasur të drejtë për të marrë licencë për të ushtruar veprimtari sigurimi, shoqëria tregtare duhet të regjistrohet sipas ligjeve irlandeze për shoqëritë tregtare, dy të tretat e aksioneve të saj duhet të jenë në pronësi të shtetasve irlandezë dhe shumica e anëtarëve të këshillit të administrimit (pa përfshirë administratorin me orar të plotë) duhet të jenë shtetas irlandezë (Ligji për Sigurimet, i vitit 1936, neni 12; Ligji për Sigurimet, i vitit 1964, neni 7).

3. Aktet ligjore, nënligjore dhe administrative që vendosin mbi përfituesit detyrimin për të dhënë një depozitë apo një detyrim të posaçëm me garanci nuk shfuqizohen nëse ndërmarrjet nuk i përmbushin kushtet financiare sipas nenit 16 dhe 17 të Direktivës së parë për bashkërendimin në përputhje me dispozitat e nenit 30 pika 1 dhe 2 të po asaj direktive.

Neni 3

1. Kur Shteti Anëtar pritës u kërkon shtetasve të vet që duan të fillojnë një veprimtari të përmendur në nenin 1, vërtetim për reputacion të mirë dhe vërtetim që nuk kanë qenë më parë objekt i procedurave të falimentimit, ose njërin prej këtyre vërtetimeve, ky Shtet Anëtar pranon si provë të mjaftueshme, në rastin e shtetasve të Shteteve të tjera Anëtare, ekstraktin e lëshuar nga një autoritet kompetent gjyqësor apo administrativ në vendin e origjinës apo vendin prej nga vjen shtetasi i huaj, ku tregohet se janë përmbushur këto kërkesa.

2. Kur vendi i origjinës a vendi prej nga vjen shtetasi i huaj nuk e lëshon një vërtetim të tillë shkresor për reputacion të mirë apo vërtetim shkresor që personi nuk ka qenë më parë objekt i procedurave të falimentimit, ky vërtetim mund të zëvendësohet me një deklaratë të dhënë nën betim - ose në shtetet ku nuk parashikohet deklarata e dhënë nën betim, me një deklaratë solemne - të cilën e jep personi i interesuar përpara autoritetit kompetent gjyqësor a administrativ ose, sipas rastit, përpara noterit, në vendin e origjinës ose në vendin prej nga vjen personi; autoriteti ose noteri lëshon një dokument për vërtetësinë e deklaratës së bërë nën betim ose të deklaratës solemne. Deklarata për mospasje procedure të mëparshme falimentimi mund të bëhet edhe përpara një organi kompetent profesional në vendin në fjalë.

3. Dokumentet e lëshuara në përputhje me pikën 1 ose në përputhje me pikën 2 nuk mund të lëshohen më shumë se tre muaj përpara datës së paraqitjes.

4. Shtetet Anëtare caktojnë, brenda afatit të parashikuar në nenin 6, autoritetet dhe organet kompetente për lëshimin e këtyre dokumenteve dhe informojnë për këtë Shtetet e tjera Anëtare dhe Komisionin.

Neni 4

1. Shtetet Anëtare sigurojnë që përfituesve t'u jepet e drejta e anëtarësimit në organizatat profesionale me të njëjtat kushte, të drejta dhe detyrime me shtetasit e tyre.
2. E drejta e anëtarësimit në organizatat profesionale përfshin, në rastin e vendosjes, të drejtën e zgjedhjes apo emërimit në postet e larta në këto organizata. Sidoqoftë, këto poste mund t'u rezervohen shtetasve kur, në zbatim të dispozitave të parashikuara me akte ligjore ose nënligjore, organizata në fjalë përfshihet në ushtrimin e autoritetit zyrtar.
3. Në Dukatën e Madh të Luksemburgut, anëtarësimi në "Chambre de commerce" nuk u jep përfituesve të drejtën e pjesëmarrjes në zgjedhjen e organeve administrative të kësaj Dhome.

Neni 5

Shteti Anëtar nuk i jep asnjë ndihmë, e cila mund t'i shtrembërojë kushtet e vendosjes, asnjërit prej shtetasve të tij që shkon në një Shtet Anëtar tjetër me qëllim ndjekjen e veprimtarive të përmendura në nenin 1.

Neni 6

Shtetet Anëtare bëjnë shtesat dhe ndryshimet përkatëse në aktet normative kombëtare në përputhje me këtë direktivë brenda 18 muajve pas njoftimit të Direktivës së parë për bashkërendimin dhe e informojnë për këtë Komisionin. Aktet normative me shtesat dhe ndryshimet përkatëse zbatohen krahas akteve ligjore, nënligjore dhe administrative të miratuara në zbatim të kësaj direktive.

Neni 7

Kjo direktivë u drejtohet Shteteve Anëtare.

Nënshkruar në Bruksel, më 24 korrik 1973.

Për Këshillin

Presidenti

I. Nørgaard

(1) GZ nr. 2, 15. 1. 1962, fq. 36/62.

(2) GZ nr. C 27, 28. 3. 1968, fq. 15.

(3) GZ nr. 118, 20. 6. 1967, fq. 2323/67.